




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-7129/24 datë:19.03.2024



Npi – 01/123 datë: 28.03.2024

Bazuar në nenet 12.2 shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Si dhe në mbështetje të nenit 7 dhe nenin 10 pika 2 të Rregullores Komunale për Simbolet, Titujt e Nderit, Dekoratat, Medaljet, Mirënjohjet dhe Falënderimet, Npi – 01/173, të datës 27.5.2009; Të nxitur nga nevoja për ndarjen e çmimit “Pena e Artë” për personalitetet që kanë dhënë kontribut domethënës në fushën e arsimit, shkencës, kulturës dhe artit, si dhe duke respektuar procedurat e akteve ligjore dhe nënligjore, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e mbajtur më: 28.03.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

**PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONIT PËR NDARJEN E ÇMIMIT
“PENA E ARTË”**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në Seancën e -III- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 28.03.2024, unanimisht e zgjodhi Komisionin për ndarjen e çmimit “Pena e Artë” në Komunën e Shtimes, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve si vijon:

1. Lulzim Sahiti – I emëruar nga Kryetari i Komunës (Anëtar i Komisionit)
2. Abdyl Hajredini – I emëruar nga Kryetari i Komunës (Anëtar i Komisionit)
3. Muhamet Ademaj – Përfaqësues i Kuvendit nga pozita (Anëtar i Komisionit)
4. Albana Podvorica – Përfaqësuese e Kuvendit nga opozita (Anëtare e Komisionit)
5. Banush Imeri – Përfaqësues nga Shoqëria Civile (Anëtar i Komisionit)

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, Npi-01/108 datë: 26.03.2024.

III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi